

VENDIM
Nr. 109, datë 4.2.2015

**PËR FINANCIMIN DHE ZBATIMIN E PROCESIT PËR LUFTIMIN MEKANIK TË
PROÇESIONARES SË PISHËS SË ZEZË NË SHKALLË VENDI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr.160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit prej 250 000 000 (dyqind e pesëdhjetë milionë) lekësh, nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, për luftimin mekanik të procesionares së pishës së zezë në shkallë vendi, nga zëri “shpenzime kapitale”. Përdorimi i fondeve do të bëhet sipas aneksit nr.1, bashkëlidhur këtij vendimi.
 2. Efektet financiare, sipas aneksit nr.1, bashkëlidhur, do të përballohen nga programi “Mbrotja e mjedisit”, miratuar për vitin 2015 për Ministrinë e Mjedisit.
 3. Procesi i luftimit të procesionares do të realizohet sipas aneksit nr.2, bashkëlidhur këtij vendimi, si dhe do të drejtohet nga koordinatori kombëtar dhe tre koordinatorët rajonalë.
 4. Koordinatori kombëtar emërohet me urdhër të Kryeministrit, me propozim të ministrit përgjegjës për mjedisin, për një periudhë prej një muaji, ndërsa koordinatorët rajonalë emërohen nga koordinatori kombëtar, me propozim të ministrit përgjegjës për mjedisin, për të njëjtën periudhë.
 5. Paga e koordinatorit kombëtar barazohet me pagën e kategorisë II-b, ndërsa e ajo e koordinatorëve rajonalë barazohet me pagën e kategorisë III-b, në institucionet qendrore.
 6. Ngarkohet ministri përgjegjës për mjedisin për miratimin e manualit për procedurën e luftimit, supervizimit, rekrutimit, trajnimit të të punësuarve, detyrimet institucionale dhe çdo element tjetër të nevojshëm për realizimin e luftimit mekanik të procesionares.
 7. Ngarkohet Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për identifikimin e burimeve njerëzore të nevojshme për realizimin e luftimit mekanik të procesionares. Punonjësit që do të kryejnë këtë aktivitet do të trajtohen me pagën prej 39 000 (tridhjetë e nëntë mijë) lekë në muaj, për periudhën e kryerjes së këtij procesi.
 8. Ngarkohet Ministria e Mjedisit, Ministria e Financave dhe Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

ANEKSI-1

Shpenzimet për punimet dhe për luftimin mekanik të procesionares së pishës së zezë

Nr.	Emërtimi i procesit të kostuar	Lekë/njësi (1 Ha)	Total Lekë për sasinë e planifikuar (6335 Ha)
1	Prerje, transport dhe asgjesim I geskave të infektuara	39 114	247.793.500
2.	Paga për strukturat e planifikuara. (Koordinatorët)	52	329 000
3.	Kosto të transportit dhe shpenzime operative të strukturave të planifikuara.	50	320 000
4.	Dieta për shpenzime qëndrimi dhe akomodimi për koordinatorët	56	357500
5.	Shpërblime të stafit të DSHP të përfshirë në operacion.	189.4	1 200 000
	T O T A L I	39461.4	250.000.000

ANEKSI -2

VENDODHJA E OBJEKTEVE, FUQIA PUNËTORE E NEVOJSHME, DHE AFATI I ZBATIMIT TË PROJEKTT KOMBËTAR PËR LUFTIMIT E PROCESIONARES.

Qarku	Rrethi	Komuna/Bashkia	Ekonomia Pyjore	Vendodhja e objektit	Sipërfaqja (në Ha)	Fuqi punëtore	Afati i kryerjes së punimeve
Shkodër	Malësi e Madhe	K. Shkrel	Fushë zezë.	Razëm	50	50	15 Shkurt-15 Mars
	Pukë	K. Luf-Qerret	Gomsiqe	Kthesat e Gomsiqes	300	300	15 Shkurt-15 Mars
	Pukë	B. Pukë	Tërbun	Kurora e Pukës	250	250	15 Shkurt-15 Mars
	Fushë Arrës	B. F. Arrës	Kryezi-Bicaj	Kurora e F.Arrës	120	120	15 Shkurt-15 Mars
Dibër	Mat	Xibër	Linot-Guri I Bardhë	Mazije-Shkallë	100	100	15 Shkurt-15 Mars
	Mat	B. Klos	Plani I Bardhë	Dushku I Kuq, Q. Buall	30	30	15 Shkurt-15 Mars
	Bulqizë	B. Bulqizë	Sheshe Bulqizë	Tek pishat	60	60	15 Shkurt-15 Mars
	Bulqizë	K. Fush Bulqizë	Liqenet e Bulqizës	Fush-Bulqizë	60	60	15 Shkurt-15 Mars
Elbasan	Elbasan	K. Gjinar	Fushë kuqe – Zavalinë	Gjinar	100	100	15 Shkurt-15 Mars
	Elbasan	K. Labinot Mal	Shmil-Zaranikë	Shmil, Zaranikë	110	110	15 Shkurt-15 Mars
	Librazhd	K. Qendër	Qarrishtë	Qarrishtë, Librazhd Katund, Dorëz	300	300	15 Shkurt-15 Mars
	Librazhd	B. Prrenjas	Prrenjas	Korora e Prrenjasit	120	120	15 Shkurt-15 Mars
	Librazhd	K. Orenjë	Çermenikë	Orenjë	125	125	15 Shkurt-15 Mars
	Librazhd	K. Hotolisht	Vehçan	Hotolisht	150	150	15 Shkurt-15 Mars
	Librazhd	K. Stravaj	Stravaj	Stravaj	80	80	15 Shkurt-15 Mars
	Gramsh	K. Godovjat	Dushku Bulcarit I	Godovjat	430	430	15 Shkurt-15 Mars
	Gramsh	K. Skënderbegas	Vidhan Skënderbegas	Skënderbegas	250	250	15 Shkurt-15 Mars
Korçë	Korçë	B. Korçë K. Mollas K. Drenovë K. Pojan	Zëmbllak Qarr	Korora e qytetit të Korçës nga Q. Qarrit - Moravë	1400	1400	15 Shkurt-15 Mars
	Korçë	K. Voskopojë K. Lekas K. Voskop	Voskopojë 1 Voskopojë 2	Kampi Voskopojë, Lekas	500	500	15 Shkurt-15 Mars

	Korçë	K. Vidhkuq	Vithkuq- Lubonjë	Gjanç dhe Pisha e Roshanit	500	500	15 Shkurt-15 Mars
	Korçë	B. Korçë B. Maliq K. Voskop	Maliq-Dersnik	Pyllëzimi mbi fshatin Pelenë	500	500	15 Shkurt-15 Mars
	Devoll	B. Devoll K. Vranisht K. Progër	Përparim- Dardhë	Fshati Përparim, mbi Dardhë	400	400	15 Shkurt-15 Mars
	Pogradec	B. Pogradec K. Udenisht	Guri I kuq-Lin	Mbi rrugën auto Lin-Pogradec	400	400	15 Shkurt-15 Mars
TOTALI					6335	6335	